



Funded by
the European Union

VET-WEB

Vlerësimi i Përvojave

për trajnime në Ballkanin Perëndimor

1 Janar 2023 – 31 Dhjetor 2024

Ref. projekti: 101092483

D 3.4 VETWEB - Final dhe i Çertifikuar

Per shperndarje



Funded by
the European Union

TABELA E PERMBAJTJES

Pakete pune	3
Tipi i Publikimit	D3.4
Niveli i Publikimit	PU - Public
Partner Lider	CONSORZIO COMMUNITAS
Pergjegjes	CONSORZIO COMMUNITAS
Authors	CONSORZIO COMMUNITAS Kontributi nga te gjithë partneret
Rishikues	Te gjithë Partneret
Version	1



Funded by
the European Union

INDEX

TABELA E PËRMBAJTJES	2
HYRJE	Errore. Il segnalibro non è definito.
QELLIMI I RAPORTIT	4
METODOLOGJIA E MIRATUAR	Errore. Il segnalibro non è definito.
KONSIDERATA FINALE RRETH TREGUESVE	4
MODELI BASHKEPUNIMIT	5
TRAJNIMET DHE MJETET	Errore. Il segnalibro non è definito.
REKOMANDIME.....	Errore. Il segnalibro non è definito.



Funded by
the European Union

HYRJE

PROJEKTI VET-WEB

VET-WEB adreson nevojat e sistemit të AFP-së në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në Shqipëri dhe Mal të Zi, për ta rinovuar dhe modernizuar atë, me qëllim që të promovojë konkurrencën e qëndrueshme, atraktivitetin dhe aftësinë për të ofruar shërbime trajnimi, në përputhje me kërkesat e reja të sektorëve ekonomikë në zhvillim, duke kontribuar me përfshirjen në treg të komunitetit nga zonat rurale dhe rrethinat e qyteteve .

FUSHAT TEMATIKE që mbështet VET-WEB mund të jene: Përmirësimi i njohurive, aftësive teknike, menaxheriale dhe pedagogjike të mësuesve dhe trajnerëve të AFP-së; rritja e kompetencave kryesore duke përfshirë Sipërmarrjen;

Grupi kryesor i synuar i AAP-WEB do të jetë: 1) menaxherët, trajnerët dhe stafi i ofruesve të AFP-së në Shqipëri dhe Mal të Zi; 2) Operatorët, menaxherët e burimeve njerëzore dhe CEO të ndërmarrjeve; 3) Operatorët dhe drejtuesit e ndërmarrjeve sociale të sektorit të tretë që veprojnë në fushën e përfshirjes sociale dhe të punës; 4) Operatorët dhe vendimmarrësit e qendrave të punësimit dhe shërbimeve sociale.

Grupi i dytë i synuar janë: të rinjtë me aftësi të ulëta të moshës nga 18-24 vjeç në situata të veshtire dhe shume të veshtire për arsye sociale (p.sh. varfëria), gjeografike (p.sh. zonat rurale), gjinore (gratë).

OBJEKTIVAT SPECIFIKE TE VET-WEB, janë:

Ndër objektivat specifike qëndron stimulimi i fluksit dhe shkëmbimi i njohurive midis sistemit të formimit profesional dhe aktoreve të tregut të punës, për të lidhur hendekun midis dy anëve të tregut të punës, për të shkurtuar tranzicionin nga bota e arsimit në botën e punës, veçanërisht në sektorët ekonomikë në zhvillim.

QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti mbledh rezultatet e arritura në 3.3 dhe rregullon të dhënat përfundimtare nga përdoruesit dhe partnerët rreth 4 treguesve kryesore të Projektit VET-WEB.

METODOLOGJIA E MIRATUAR

Për të siguruar lidhjen midis rezultateve të paraqitura në treguesin 3.3 dhe materjalit aktual-Konsorciumi, (pervec asaj që është bërë deri tani gjatë fazës së testimit), vendosi të shtojë një tryezë e rrumbullakët mbi rezultatet dhe qëndrueshmërinë në të ardhmen, e cila u realizua në Milano në datat 4 dhe 5 Dhjetor 2024. Kjo beri të mundur që të gjithë partnerët, veçanërisht ata nga Mali i Zi dhe Shqipëria të përmbledhin rezultatet e trajnimeve të organizojnë një diskutim të hapur rreth rëndësisë së përdorimit të ketyre mjeteve dhe instrumenteve si dhe boshlliqet që vërehen në përdorimin e tyre. Për më tepër, tryeza e rrumbullakët u dha atyre mundësinë që të kishin një hapësirë të lirë për të paraqitur kornizat



e tyre kombëtare dhe sfidat që ato sjellin - një element thelbësor që mund të përshpejtojë ose frenojë zbatimin e instrumenteve dhe mjeteve në sistemin e AFP-së.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTARE RRETH TREGUESVE

Duke marrë në konsideratë dëshmitë e rezulttit 3.3 dhe rezultatet nga tryeza e rrumbullakët, del se të tre rezultatet ishin në gjendje t'i përgjigjen si nevojave të partnerit ashtu dhe objektivave të projektit. Gjithsesi, për mirëmbajtjen dhe qëndrueshmërinë e tyre të mëtejshme është e rëndësishme të merren parasysh sugjerimet e mëposhtme nga partnerët dhe pjesëmarrësit në aktivitetet e trajnimit:

MODELI I BASHKEPUNIMIT

MALI I ZI

Përveç marrëveshjes së përgjithshme mbi efektivitetin e modelit, partnerët nga Mali i Zi sugjeruan vazhdimin e aktiviteteve të shpërndarjes, shkëmbimit të stafit për të optimizuar dhe shumfishuar ndikimin e modelit. Sugjerimet përfshinin:

- nxitja e politikave publike për të përmirësuar koordinimin ndërmjet arsimit dhe shërbimeve të punësimit;
- nevoja për një rritje të investimeve në AAP përmes financimit, infrastrukturës dhe kornizave rregullatore;
- rritje e mbështetjes për përfshirjen e të rinjve në situata të favorshme
- një akses më i gjerë në programet e AFP-së me cilësi të lartë.

SHQIPERIA

Meqenëse kishte një nivel të lartë interesi për modelin, partnerët shqiptarë kërkuan një gamë më të gjerë të rasteve të studimit, mjeteve dhe instrumenteve të mbështetjes vizuale, për të rritur përdorshmërinë dhe rëndësinë e modelit. Sugjerimet e mëtejshme përfshinin një theks më të madh në angazhimin e palëve të interesuara, veçanërisht ndërmjet organizatave të AFP-së dhe qendrave të punësimit.

BELGIKA

Sipas mendimit të disa pjesëmarrësve, cilësia e modelit kërkonte shembuj më praktikë për të pasur një kuptim lokal të zbatimit të tij.

SPANJA

Partneri uroi për një monitorim të vazhdueshëm të evolucionit dhe ndryshimeve në modelet kombëtare të AFP-së të vendeve të ndryshme pas përfundimit të projektit.



ITALIA

Modeli u konfirmua pa asnjë vërejtje.

MODELI I QEVERISJES DHE PËRFSHIRJES

MALI I ZI

Partnerët ranë dakord për cilësinë e modelit, por sugjeruan një fokus më të thellë në zbatueshmërinë e tij në kontekstin lokal nëpërmjet trajnimeve të mëtejshme.

SHQIPERIA

Ashtu si në modelin e mëparshëm, partnerët vlerësuan modelin e qeverisjes dhe përfshirjes, por, për shkak të interesit për modelin, partnerët shqiptarë sugjeruan të kishin:

- një udhëzim të thellë mbi angazhimin e palëve të interesuara;
- një grup më i gjerë i rasteve të studimit dhe ndihmave vizuale;
- një lidhje më e qartë midis mjeteve dhe përfitimeve për përdoruesit.

Ashtu siç u sygjera nga Mali I Zi, trajnimet e mëtejshme mund t'i zgjidhin të gjitha këto aspekte.

BELGIKA

Sygjeri dhe kërkoi për shtimin e më shumë shembujve praktikë apo rasteve studimore.

SPANJA

Për të përmirësuar rezultatet e partnerit model kërkoi një përditësim të rregullt të rregulloreve të vendeve të BE-së për njerëzit më vulnerabël dhe në marrëdhëniet midis AFP-së dhe shërbimeve të mirëqenies.

ITALIA

Modeli u konfirmua pa asnjë vërejtje.

TRAJNIMET DHE MJETET

MALI I ZI

Sugjerimet për përmirësime të mëtejshme kanë të bëjnë me mundësinë për të pasur më shumë ushtrime praktike për të përditësuar përmbajtjen dhe për t'u fokusuar në fusha specifike. Për më tepër, u kërkua një fokus në njohjen e aftësive të fituara në mjedisin



Funded by
the European Union

joformal, veçanërisht ato të fituara në sektorin e tretë nëpërmjet vullnetarizmit ose shërbimeve arsimore me bazë komunitare.

SHQIPERIA

Partnerët vlerësuan gjerësisht mjetet dhe trajnimet duke kërkuar shembuj më praktikë dhe raste studimore.

BELGIKA

Partneri vlerësoi modelin dhe theksoi rëndësinë e elementeve të mëtejshme të rasteve studimore.

SPANJA

Trajnimet dhe mjetet janë konfirmuar pa asnjë vërejtje.

ITALIA

Partnerët e vlerësuan modelin dhe raportuan atë që doli nga pjesëmarrësit në trajnime që të ketë sa më shumë informacion udhëzues rreth funksioneve të Europass.

REKOMANDIME

Në përgjithësi, për të rritur zbatimin e modeleve dhe për të mbështetur njohjen e kornizave dhe mjeteve të BE-së në vendet partnere të BB-së, mund të merren parasysh elementët e mëposhtëm:

- të ofrojë programe të mëtejshme trajnimi për një përshtatje më të mirë të mjeteve në nivel kombëtar.
- të nxisin bashkëpunimin ndërmjet palëve të interesuara si organizatat e biznesit, AFP dhe arsimit, qendrat e punësimit me qëllim për të siguruar një përdorim më të gjerë të mjeteve dhe për të maksimizuar ndikimin e tyre.
- të përditësojë modelet me raste studimore dhe të organizojë seminare, vizita studimore për të frymëzuar vazhdimisht palët e interesuara dhe vendimmarrësit në nivel kombëtar dhe lokal.
- të avokojë për politika që mbështesin zbatimin e mjeteve në nivel kombëtar.